

IZLAZNI - DALËSE  
01-020108-11874118

Br.Prot.  
Prot.  
str.  
Nr.i fq.  
Datum  
Data

1  
25.09.2018

ŠTRPCE - SHTËRPCË



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 24/09/2018 miratoi këtë :

### V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 20.07.2018

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo  
Opština Štrpcë  
Komuna e Shterpçës  
Municipality of Strpce



## PROCESVERBAL

Nga seanca e gjashtë të rregullt e KK-ës të mbajtur më 20.07.2018, me fillim në ora 10:00

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së
3. Shqyrtimi dhe aprovimi raportit gjashtëmujor e kryetarit
4. Prezantimi raportit finansiar gjashtëmujor për përudhen janar- qershori 2018 dhe raporti për nivelin pagesave të hyrave vetanake.
5. Të ndryshme.

### 1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

**Predrag Grbic:** Të respektuari zëvendësit e kryetarit, këshilltar, drejtoret e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE dhe të gjithë të tjera të pranishëm, mirëdita dhe mirë se vini në seancën e gjashtë të rregullt të K.K. Shterpçë. Në seancën e sotme janë të pranishëm të gjithë 15 këshilltarë që do të thotë se kemi kuorumin dhe mund të fillojmë me punë. Unë dua vetëm të ju informoj për një gjerë, unë nga z.Rifat Rustemi dhe Blerta Hazizi e kam marr një njoftimin në të cilin shkruan: I respektuari kryesues i KK Shterpce, ju njoftojmë që nga data 25.06.2018 dy përfaqësuesit e KK Shterpce Rifat Rustemi dhe Blerta Haziri do të përfaqësojnë subjektin Nisma Socialdemokrate në punën e mëtejshme e KK Shterpce. Njoftimi është i obliguar për shkak të procedurave ligjore dhe administrative. A lajmërohet dikush për fjalë. Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim pik e rendit të ditës.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua rendin e ditës

### 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluare KK Shterpce

**Predrag Grbic:** A lajmërohet dikush për fjalë?

**Rifat Rustemi :** Sa për këtë procesverbal, ka pak telashe, edhe sa kam vërejtur unë është mungesa e personelit se ka një here është mire ka një here ka shumë problema, ka mundur me qenë gabim teknik, sepse fjalë përfaqësuesit Garip Sahiti kur e ka ngrit një çështje, atu shkruan **Rifat Rustemi**, si kishe unë e kam ngrit këtë çështje, ndoshta ka qenë gabim teknik por është

mirë që të korrigjohet. Edhe nuk figuron numri i faqes, nëse unë dua ta ngrit një çështje edhe dua më fol për një faqe caktuar, nuk mundem të di cila faqe është. Si janë renditur këtu, është faqja e tret, kur kam folur për subvencione, unë kam thonë që subvencione përmjedra, nuk nevojiten subvencione nëse nuk ju sigurohet tregu, sepse tregu i mjedrave është shumë i pasigurt, sepse mjedra po grumbullohen edhe punohen, por nuk dihet sa ka me qenë çmimi, këtu shkruan kundërta. Faqja e 6, di qe qytetaret kanë reaguar përmirëmbajtje dimërore e rrugës, kam cekur edhe më herët që rrugë janë mirëmbajtur mire, nuk ka pasur telashe edhe sepse dimri nuk ka pasur shumë reshje, diku thuhet ashtu diku ndryshe, unë mendoj që problemi është të personeli, është mirë në të ardhmen të pranohet edhe një punëtor, përmë me qenë me saktë.

**Predrag Grbic:** E pranojmë vërejtjen e juaj, dhe ajo do te korrigjohet në procesverbal. Në kemi edhe një punëtor tjetër, por ajo është në pushim lehonisë, përmë ata këtë punë në komunën e kryen vetëm një përkthye, edhe ajo nuk e ka punë vetëm me përkthye ato që ke të bëjë më Kuvendin, por edhe shumë gjera tjera. A lajmërohet dikush përfjalë. Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim këtë pik e rendit të ditës.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua rendjin e ditës

### **3. Shqyrtimi dhe aprovimi raportit gjashtëmuajor e kryetarit**

**Predrag Grbic:** Ky raport, si dhe pika e ardhshme ka informacionet e ngjashme, por ligji kërkon që të kemi to dy raportet dhe ato në muajin korrik. Në këtë raport e punës së kryetarit, shihet se cilat ishin objektivat dhe aktivitetet themelore e udhëheqjes së komunës në 6 mujorin e par në vitin 2018, nuk ka nevojë që të përsëriti ato që keni lexuar. Në pjesën e dytë gjendet raporti i të secilës drejtori që funksionon në komunën tonë. Hapi diskutim, a lajmërohet dikush përfjalë?

**Rifat Rustemi:** Kam lexuar material edhe në faqen 6, të zyra e arkivist, thuhet se e mbani evidencën përgjithë arkivin edhe komunikon me qytetaret në meny korrekte dhe transparente në gjuhën e atyre amtare, sa përzyrën e arkivist është gjithçka në rregull, me pritje më shërbim që e afrojnë qytetareve, sa përkomunikim, unë vet kam pasur ka një here problem, me gjuhën serbe sepse shumë pak e flas, edhe atu janë punëtor të cilit punojnë një kohë bukur gjatë, punojnë korrekt edhe mirë vetëm sa i përket gjuhës, nuk e din gjuhën shqipe, edhe është mirë që në të ardhmen të mësojnë pak, ose të shkojnë më një kurs, sepse janë zyra që ka shumë punë me qytetaret. Faqja 7, puna për organizimin e diskutimeve publik përmë emërimi e rrugëve në territorin e komunës së Shtërpëces, po dua me dit përmë cilin organizimi bëhet fjala, më intereson kjo çështje përmë emërimin e rrugëve, ku ka ngecur, sepse është mirë me u zgjidh, ndoshta nuk është pazgjidhshme, sepse më duket që vetëm ne kemi metë pa e emëruar rrugët. Është mirë që të anashkalojmë këtë problem. Faqja e Facebook, nuk di si e ka emrin kjo faqja. Sa përmë këtë faqe është tu mirëmbajtur bukur, mire por ende ka punë, nuk ka dhëna përmë drejtorët. Nëse mu më intereson një drejtor e drejtorisë së caktuar përmë të kontaktuar, një numër e kontaktit nuk mundesh më gjet, ose një përfaqësuesit e kuvendit, është mirë më pas ato dhëna, përmë punëtor dhe zyrtar e komunës, përmë mos me ardhur me u informua këtu, por me u informua nga shtëpia, po mire është që ka filluar përmë drejtim mbar. Edhe në faqen 14, drejtoria ka filluar me realizimin e projekteve përmë mirëmbajtjen e rrugëve lokale edhe mirëmbajtjen e të gjithave varrezave në komunën e Shtërpëces. Kjo është e vërtet, ka filluar, edhe e uroj përmë këtë, por sa përmë varreza më duket që nuk është tu shkuar bash mirë puna, duhet më mbikëqyr pak më mirë.

**Radojka Repinovic:** Në raportin e gjashtëmuajor e punës së kryetarit, fokusi i punës është

përmirësimi e standardeve ekonomike të qytetareve të komunës tonë. Në veçanti, nxitjes së vetëpunësimit përmes bujqësi, si dega jonë kryesore ekonomike, kryesisht tu e gjet zgjidhje, ndihmë për lidhjen e marrëveshjeve më organizatat ndërkombe të cilat e financojnë punësimin. Sfidat e konstante, siç që janë: turizmi në komunën tonë, në atë proces, kryetari po angazhohet dhe edhe është i përkushtuar në zhvillimin e turizmit në komunën tonë. Në raport në detajet është përshkruar puna e të gjithë drejtorive e komunës. Parashikohen sistematizimet të cilat përcjellin dhe e përkrahin punën e kryetarit, të cila është në interes të qytetareve tonë. E falënderoj për këtë informata të detajuar të cilat janë në këtë raport dhe propozoj aprovimin e tij.

**Rifat Rustemi:** Pota më cek edhe një të mirë që është kam vërejtur të drejtoria për mirëqenies sociale që numri në ekzistence sociale ka ra, do më thonë që kjo është mirë, vetëm këto desha më cek.

**Predrag Grbic:** Sa i përket komunikimit, gjuhës dhe ueb-faqes, propozimi juaj është në vend, për ata nuk kam asnë kundërshtim. Do të mundohemi që ato gjera nuk ndollën më, në të ardhmen, e di që ata janë shumë korrekt në at zyrë. Unë këto e kam kuptuar si propozim, a jo si kritik. Sa i përket emërimin e rrugëve, unë kam treguar që drejtorët kanë bërë çmos për të përfunduar këtë raport, kështu që për këtë kuvend ishte e pamundur që të bëhet dhe kjo çështje për emërimin e rrugëve. Kemi biseduar me njerëzit nga zyra e kryetarit dhe ajo është njëra nga çështjeve që ndoshta do të gjendet në Kuvendin e ardhshëm. Sa i përket debatit për rrugë, ajo është për Drejtorin e Financave, përgjigje do të merrni në seancën e ardhshme.

**Sinisa Buduric:** Sa i përket projektit e mirëmbajtjes së varrezave në territorin e komunës së tonë, projekti ka filluar para një muaj, dhe zgjat një vjet. Për shkakun të kohës të keqe përkohësisht, kemi pezulluar projektin, por nesër do të vazhdojmë me projektin.

**Predrag Grbic:** A lajmërohet dikush për fjalë. Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim këtë pik e rendit të ditës.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua rendin e ditës

#### **4. Prezantimi rapportit finanziar gjashtëmuajor për përudhen janar- qershor 2018 dhe rapporti për nivelin pagesave të hyrave vetanake.**

**Danijel Vuksanovic:** Duke pas parasysh se ky është rapporti i tret dhe që dhënat janë të detajuara, unë do të filloj më të dhënat më të rëndësishme. Kemi pasur vetëm një ndryshim sa i përket buxhetit. Në fillim të vitit buxheti ishte 3.746.219, në tremujorin e par e kemi transferuar 135.314.63, por, na në tremujorin e dytë kemi marr shumën prej 28,871€, ajo është një donacioni nga projekti DEMOS i cili është i lidhur më përfomancën e komunës për vitin 2016. Kjo është dëshmi lidhur me esencën e fundit ku kamë përmendor që komuna e Shtërpëcës është një nga 5 më të mira në Kosovë, dhe për ata e kemi marr këtë shumën. Kjo shuma shkon në projektin kapitale për f. Firaja, për zëvendësimin e ndriçimit LED. Buxheti i përgjithshëm tani është 3.899.213€. Në faqen 13 keni të gjitha dhënat sa janë shpenzimet, me alokime janë 61% dhe një buxhet të përgjithshëm prej 40.41%. Sa i përket të hyrave vetanake të cilat përbëjnë buxhetin total me grandin e qeveritar, plani për vitin 2018 është 303.2820128. Na në gjashtëmuajorin e par kemi grumbulluar pak më shumë si 150.000€, që është mbi 50%, kjo është hera e par që ndoll diçka e tillë në komunën tonë.

**Predrag Grbie:** A lajmërohet dikush për fjalë. Nëse nuk lajmërohet askush kalojmë në piken e ardhshme

## 5. Të ndryshme.

**Rifat Rustemi:** Kam një lavdi për drejtorin e shërbimeve publike edhe një shqetësim, sa për drejtorin e shërbimeve publike ne seancën e kaluar kam ngrit shqetësim përrugët që janë shkartuar prej reshjeve atmosferike. Kanë metë disa rrugë, por njëra është arritur të përfundon shumë mirë, përvèç kanalit, atu janë tu punuar edhe besoj qe do të rregullohet kjo është mirë për arsyen që nëse ka shumë probleme dhe nëse duam më zgjidh, nuk mundemi më zgjidh të gjitha por nëse e zgjidhmi vetëm një është mire, sepse jetë një me pak për të ardhmen, është mirë që ka marrë më seriozitet kërkesën time nga seanca e kaluar, e përgëzoj për punën. Edhe një shqetësim tjetër, nuk e di a keni dëgjuar, në kohen e fundit është folur për prerje ilegale e pyjeve, është folur edhe në takimin e komitetin për siguri në bashkësi kam qenë prezent. E ndjekim vazhdimi, e di që është shqetësim edhe mali më ka ec. Tani janë tu ndërmarr do masa shumë mirë, por mua personalisht nuk më pëlqejnë ato masa, nuk jam tu thonë që dikush nga komuna, prej zyrtareve komunës ka qenë në bashkëpunim me qeverinë ose me ministrin e Ambientit, sepse ajo menaxhon me parkun nacional Shar, kanë ndërmarr disa masa më bager dhe ekskavator dhe të gjitha rrugë që qojnë ka bjeshka e kanë deformuar, e kanë bërë gropë skeptike neper rrugë, pos asaj tani është rizik edhe për njerëzit dhe fëmija që kalojnë atje pare, sepse mundet me ra në ato gropë edhe mundet të vjen deri të humbja e jetesë, kanë shkathuar edhe ujësjellësin më të cilin furnizohen njerëzit me ujë, kanë dal gypat mbi dhe, mundeni me pa nëse dilni në vizitë, kush e ka hapur ato rrugë nuk e di, unë nuk besoj që ruhet mali më ato gropë dhe duke deformuar rrugë. Rojtar duhet me ruajt, di së ka mungesa e rojtareve, nëse ka nevojë me bërë zgjidhje me ruajt malin edhe me zdatu ligjin, a jo me bërë gropë skeptike edhe me deformua rrugë, sepse në krejt Evropën hapen rrugët për me dal njerëzit në piknik ose për qef. Këtu nëse donë për qef me dal më u shëtit nuk mundesh me kaluar rrugën atu, kjo është shumë shqetësuese për mua, kisha dashur që dikush nga zyrtareve e komunës sadopak mirët më këtë quesim pylltar prej punës.

**Predrag Grbic:** Kjo pyetje të cilin e keni parashtruar është e lidhur me drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, për ata që njësia e pyjore është nën juridiksionin e tyre. Mos harroni se në territorin e komunës tonë jonë edhe pyjet që janë nën juridiksionin e Parkut Kombëtar. Unë kam pasur rastin me pa, që pylltarët nga Parku Kombëtar kanë bërë pengesat të ndryshme për të ndaluar prerje jolegale e pyllit. A është kjo një nga mënyra e tyre për të parandaluar njerëzit që të shkojnë me traktorët deri në ato vende ose jo, perime nuk di. Tani drejtori për zhvillim ekonomik nuk është prezent këtu, sepse sot komunën tonë e viziton ambasadori i Austrisë, si dhe përfaqësuesi i përhershëm i UNDP-ës për Kosovën, dhe aj është i detyruar që të merr pjesë në at takim. Përgjigje do të merrni në seancën e ardhshme. Nuk na keni treguar në të cilat vende janë, për me dit çfarë të themi, për të mundur ata të shkojnë atje dhe të shohin për çka është fjala.

**Rifat Rustemi:** Unë të gjitha lokacione e kam fotografuar në telefon, mundem me printu dikun edhe me ju dhënë, janë dy rrugë në lagjen Emerllahaj që shkojnë në pyll, edhe to dy rrugë janë deformuar, njëra është rruga private, ajo është hapur privat edhe at rrugën e kanë deformuar.

është edhe rruga cila nga lagja Emerllahaj shkon të shkolla. Nëse ka nevojë, nëse dikush donë me dal, unë jam i gatshëm me dal me atë, për më vizituar ato gropë që janë bërë, Është edhe rruga në Firaj që shkon për Lubote. Njerëzit e kanë bagëti që janë atje edhe kanë pasur problem për me kaluar rrugën atje. Janë 6 gropë skeptike që janë bërë në pjesën e Brodit dhe Firajws. A për pjesën Serbe nuk kam informata nuk e di a ka. Edhe ju garantoj që mali vazhdimishtë është tu pre. Nuk kanë dhënë asnje efekt ato gropë skeptike, sepse apët e kanë gjetur zgjidhje alternative edhe është tu vazhduar prerja e malit. Mirë, edhe çka kanë bërë, vetëm kanë rrezikuar banoret edhe ju kanë vështirësuar rrugën për me dal në Luboten. Tani është edhe sezoni e qershive dhe njerëzit duan të mbledhin ato, edhe njerëzit shumë e presin këtë sezon, dëshirojnë me dal me u shëtit, koj është shumë e shqetësuese. Edhe gypat janë jashtë edhe minden me u dëmtohen ato gypat dhe nesër minden mbesin pa ujë banoret.

**Prerag Grbic:** Na do të ndërmarrim të gjitha masat që janë në juridikcion tonë. Nëse ajo është në juridikcion e Parkut Kombëtar, do të kontaktojmë ata, për të zgjidhur këtë problem. Po, keni lavdëruar drejtori e drejtorisë së Shërbimeve Publik, edhe unë e kam bërë ato në një seancë paraprake, sepse shumë mirë e bënë punën e tij, edhe ditën edhe natën kur e thërrasin dhe kur nevojitet. A lajmërohet dikush tjetër përfjalë? Meqë askush nuk lajmërohet, seanca e sotme ka mbaruar.

Procesmbajtësi  
Staja Markovic

Kryesuesi i Kuvendit  
Predrag Grbic

